



BASHKIA  
TIRANË

Nr. Prot. 24052/F

Tiranë 5/8 / 2016

**SHTESË KONTRATË SIPËRMARRJE**

**OBJEKTI**

***“Rikonstruksion i “Licent Artistik Jordan Misja”.***

**2016**

Adresa: Shëtitorja, “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri, Tel/Fax: +355 4 2256 799 [email@tirana.gov.al](mailto:email@tirana.gov.al)

## SHTESË KONTRATË SIPËRMARRJE

### “Shtesë kontrate për “Rikonstrukcion i “Licent Artistik Jordan Misja”.

Lidhur sot më datë \_\_\_\_\_ 2016 në bazë të nenit 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), Neni 33 pika 5 gërma “a” si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 , datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu IV , Neni 36 pika 2 gërma “dh” si dhe në mbështetje të kontratës fillestare me Nr. 3823/4 Prot. datë 09.02.2016 Neni 27 pika 2, midis;

**Bashkisë së Tiranës**, e përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me adresë: Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 2, 1001, Tiranë, që më poshtë do të quhet **“Autoriteti Kontraktor”**;

dhe

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë **“Ed Konstruksion” shpk & “4 A-M” shpk**, regjistruar respektivisht si më poshtë shënuar:

Shoqëria **“Ed Konstruksion” shpk** e regjistruar me Vendim Gjykatë Nr.33356, datë 12.04.2005, me licensë profesionale të shoqërisë NZ.4981/8, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me seli të shoqërisë Rruga “Frederik Shiroka”, GV- Konstruksion, Kulla C, kati i II-të, Ap1/2 Tiranë, me NUIS K 61625001 I, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë **Z. Alfred Ibrahim**i;

Shoqëria **“4 A-M” shpk** e regjistruar me Vendim Gjykatë Nr. CN- 279014-08-09, datë 05.08.2009, me licensë profesionale të shoqërisë NZ.6546/6, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me seli të shoqërisë Rruga “Musa Agolli”, Godinë 7-katëshe, kati i II-të, Ap/18 Tiranë, me NUIS K 92005016 I, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë **Z. Ardit Metaliaj** i mëposhtëquajtur **“Kontraktor”**,

Shoqëritë **“Ed Konstruksion” shpk** dhe **“4 A-M” shpk** me anë të Kontratës për Bashkëpunimin e përkohshëm të shoqërive, lidhur më datë 05.01.2016 me Nr.48 Rep, Nr.11 Kol, Tiranë, kanë rënë dakort të bëjnë bashkëpunimin e përkohshëm të shoqërive për realizimin e objektit **“Rikonstrukcion i “Licent Artistik Jordan Misja”**. Ku shoqëria **“Ed Konstruksion” shpk** do të realizojë **47%** të punimeve dhe shoqëria **“4 A-M” shpk** do të kryejë **53%** të punimeve. Me anë të prokurës së posaçme të datës 05.01.2016, me Nr.47 Rep, Nr.10 Kol, Tiranë shoqëria **“4 A-M” shpk** autorizon shoqërinë **“Ed Konstruksion” shpk** me Përfaqësues Ligjor **Z. Alfred Ibrahim** i të jetë përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të shoqërive në realizimin e objektit të kontratës, i mëposhtëquajtur **“Kontraktor”**.

*Neni 1*  
*Objekti i shtesës së Kontratës*

- I. 1.1 Objekti i kësaj shtese kontrate është sipërmarja me objekt: **“Rikonstrukcion i “Licent Artistik Jordan Misja”**”, në përputhje të plotë me projekt - zbatimin e objektit.

*Neni 2*  
*Vlera e shtesës së Kontratës*

- 2.1 Shtesa e kontratës lidhet me një vlerë totale: **13.375.583** (trembëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

- 2.2 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas shtesës së kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruara nga kontraktori në ofertën e tij.

*Neni 3*  
*Afati i realizimit të punimeve*

- 3.1 Afati maksimal i përfundimit të punimeve është 1 (një) muaj kalendarik duke nisur nga dita e lidhjes së shtesës së kontratës.

*Neni 4*  
*Gjuha e shtesës së Kontratës*

- 4.1 Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

*Neni 5*  
*Përkufizime*

- 5.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes të dhena në projekt të cilat janë orientuese, plotësuar me emimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelasa në dore.

- 5.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes të dhena në projekt shogëruar me emimet për njësi të pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime në matje.

- 5.3 “Afati i realizimit të punimeve” do të thotë data që Punët duhet të përfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve, e vërtetuar nga enti prokurues.

- 5.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPP dhe KVK, të gjitha bashkëngjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 5.5 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

- 5.6** “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 5.7** “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 5.8** “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kanton.
- 5.9** “Data e fillimit” është përfshirë në të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 5.10** “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kanton për realizimin e Ndertimeve.
- 5.11** “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 5.12** “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 5.13** “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 5.14** “Drejtnes projektit” do të thotë Mblidhësi i Punimeve i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 5.15** “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kesaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kesaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
- 5.16** “Drejtor Teknik” është personi i caktuar nga Kontraktori në ofertën e tij, i cili përbush kualifikimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontaktues si dhe i aprovuar prej tij, i cili është personi përgjegjës nga ana e Kontraktorit për zbatimin e punimeve në Kanton deri në përfundimin e tyre, i pranishëm në kantonin e ndertimit dhe është përfaqësuesi i Kontraktuesit në të gjitha kontaktet me përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor.
- 5.17** “Kanton” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 5.18** “Raport i inspektimit të kantonit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantonit.
- 5.19** “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të Kontraktorit.
- 5.20** “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kesaj kontrate dhe sipas dispozitave të kesaj kontrate siguron Punimet.
- 5.21** “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si

rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

**5.22** “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e nderimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të nderimit.

**5.23** “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gjëmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

**5.24** “formulari i deklarimit të ofertës” - është dokumenti i plotësuar që kontraktori ka dorëzuar në datën e hapjes së tenderit dhe është pranuar nga Enti Prokurues.

**5.25** “Data e përfundimit të kontratës” është data e vërtetuar nga Enti Prokurues.

**5.26** “Ditët” janë ditë kalendarike dhe “muajt” janë muaj kalendarik.

**5.27** “Ndryshimi” është një udhëzim që jep Autoriteti Kontraktori paparashikuar në dokumentat fillestare dhe jepet gjithmonë me shkrim.

**5.28** “Raste të kompensuara” janë ato që përcaktohen në pikën 33.

**5.29** “Periudha e garancisë” së difekteve është 24 (njëzetekatër) muaj.

**5.30** “Skica (vizatimet)” përfshijnë projektet dhe të dhëna të tjera të paraqitura ose të miratuara nga Enti Prokurues për përmbushjen e Kontratës.

**5.31** “Specifikimet” janë karakteristikat e punimeve të përfshira në projektet e zbatimit në dokumentat standarte të tenderit dhe çdo modifikim ose shtesë e bëjë dhe e miratuar me shkrim nga Investitori.

**5.32** “Punimet” janë punimet që duhet të kryhen nga Kontraktori në përputhje me kontratën, projektin dhe ndryshimet e tij.

#### *Neni 6*

#### *Specifikimet teknike*

**6.1** Specifikimet teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor dhe të pranuar nga kontraktori edhe në kontratën mëmë janë pjesë përbërëse dhe integrale e kësaj shtese kontrate.

#### *Neni 7*

#### *Prona Intelektuale*

**7.1** Të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të shtesës së kontratës do të përkasin Autoritetit Kontraktor i cili i përdor ato sipas gjykimit të tij.

**7.2** Kontraktori pas përfundimit të shtesës së kontratës duhet të dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, skicimet, specifikimet planet llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose të përgatitura nga kontraktori

gjatë zbatimit të kontratës, Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave po nuk mund ti përdorë për qëllime që skanë lidhje me kontratën pa lejen me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

**7.3** Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas shtesës së kontratës.

**7.4** Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i shtesë së kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas shtesës së kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### *Neni 8 Mbikqyrësi i Punimeve*

**8.1** Bashkia e Tiranës me të drejtën e Investitorit si Autoritet Kontraktor, në mbështetje të dispozitave ligjore për drejtimin dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit dhe konkretisht Udhëzimit Nr 1, datë 16.06.2011 për “Disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar”, nëpërmjet “Procedurës me negocim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontrates”, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar), Neni 33 pika 5 gërma “a” si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu IV, Neni 36, pika 2, gërma “dh”, u lidh shtesa e kontratës me operatorët ekonomikë të kontratës fillestare shoqëritë “**Metro\_Polis**” shpk dhe “**G&K**”  
Detyrat e mbikqyrësve të punimeve burojnë nga aktet ligjore dhe n/ligjore në fuqi dhe detajohen në kontratën e shërbimit që do të lidhet me këta të fundit.

**8.2** Në rast se mbikqyrësi do të ndryshohet Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Kontraktorin.

**8.3** Mbikqyrësi i Punimeve do të vendosë për çështjet e shtesës së kontratës midis Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.

**8.4** Mbikqyrësi i Punimeve mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij te të tjerët përveç zgjidhjes së mosnarrëveshjeve dhe konflikteve. Mbikqyrësi i Punimeve duhet të njoftojë me shkrim Kontraktorin për delegimet e bëra apo të deleguara.

**8.5** Mbikqyrësi i punimeve duhet të kontrollojë Punimet e egzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraget komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

**8.6** Me përfundim të rasteve kur parashikohet ndryshe në shtesë kontratë, pagesa periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga mbikqyrësi i punimeve.

*Neni 9  
Personeli i Kontraktorit*

- 9.1** Kontraktori është i detyruar të punësojë në kantier për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Mbikqyrësi i Punimeve vetëm personelin inxhinjeric të deklaruar në ofertën e shoqërisë .
- 9.2** Mbikqyrësi i Punimeve do ti propozojë Autoritetit kontraktor për të zëvendësuar personelin kryesor vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë baraz ose më të larta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Kontraktor.
- 9.3** Në qoftë se Mbikqyrësi i Punimeve i kërkon Kontraktorit që të largojë një person, i cili është anëtar i personelit ose i fuqisë punëtore të Kontraktorit, duke theksuar arsyet, Kontraktori do të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë më lidhje me punën e përfshirë në shesë kontratë.
- 9.4** Kontraktori është i detyruar të caktojë Drejtorin Teknik. Drejtori Teknik është personi që Kontraktori ka përcaktuar në ofertën e tij. Drejtuesit Teknik të Punimeve të objektit do të jete **Z . Vullnet Sejdimi** i përfshirë në Licensen profesionale të shoqërisë “Ed Konstruksion, shpk me Nr. NZ 4981/8 lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe **Z . Bujar Kurti** i përfshirë në Licensen profesionale të shoqërisë “4 A-M, shpk me Nr. NZ 6546/6 lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:
- a) Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit
  - b) Te jete i pranishem gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve ne kantier;
  - c) Te jetë i pranishëm dhe të përfaqësojë Kontraktorin në të gjitha kontaktet, takimet zyrtare apo mbledhjet që Autoriteti Kontraktor zhvillon me Kontraktorin dhe Drejtorin e Projektit në zgjidhjen e diskutimin e çështjeve teknike e profesionale që lindin gjate zbatimit te punimeve;
  - d) Është përgjegjës per dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet në objekt;
  - e) Mban Korrespondencën zyrtare me Mbikqyrësin e Punimeve;
  - f) Është përgjegjës për ecurinë e zbatimit të punimeve konform plan organizimit dhe grafikut të punimeve;
  - g) Është i pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.
- 9.5** Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë Mbikqyrësin e Punimeve i cili vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.
- 9.6** Drejtuesi teknik ne këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlereson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara ne Dokumentat e tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një Drejtues teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Mbikqyrësin e Punimeve i cili vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

*Neni 10*  
*Detyrimet e Kontraktorit*

- 10.1** Kontraktori do të kryejë punimet në përputhje me projektet e ndryshimet e miratuara e të dhëna nga Autoriteti Kontraktor dhe në përputhje me K.T. të zbatimit të RSH, specififikimet teknike të kontratës fillestare.
- 10.2** Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specififikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor në kontratën fillestare me përjashtim të rasteve kur gabimi është aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta reklamonte tek Autoriteti Kontraktor.
- 10.3** Nëse gjatë ekzekutimit të shesës së kontratës ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standardeve këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.
- 10.4** Drejtuesi Teknik i Punimeve në kantier, është i detyruar të mbajë ditarin e objektit, ku të përfshihen të gjitha punimet e kryera dhe urdhërat e dhëna për projektin. Ky ditar në çdo kohë do ti vihet në dispozicion Mblidhësit të punimeve, grupit të kolaudimit dhe Investitorit.
- 10.5** Kontraktori do të kryejë punime me nënsipërmarije vetëm nëse Autoriteti Kontraktor e ka lejuar këtë në dokumentat e tenderit të kontratës fillestare vetëm pasi të ketë marrë miratimin e Investitorit.
- 10.6** Nënkontraktori do të jetë subjekti i deklaruar si nënkontraktor në ofertën e Kontraktorit dhe do të kryejë vetëm punimet e deklaruarra në ofertë dhe jo më shumë se 40% të vlerës së shesës së Kontratës.
- 10.7** Marrëdhëniet e n/sipërmarijes do rregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje e cila përcakton qartë nënsipërmarijen dhe që në çdo rast është e detyruar të respektojë të gjitha detyrimet e shesës së kontratës së sipërmarijes. Përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktor mbetet gjithmone Kontraktori kryesor i punimeve.
- 10.8** Kontraktori mund ti japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktori të zbatojë punën e tij sipas shesës së kontratës. Në rast të tillë kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës sic thuhet në nenin Informacioni Konfidencial.
- 10.9** Kontraktori ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij objekti. Gjithashtu të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Investitorit.
- 10.10** Kontraktori është i detyruar të marrë të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së ambientit duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.



- 10.11** Kontraktori është i detyruar të rrethoje kantierin e punimeve të ndërimit në datën e fillimit dhe hyrjes në kantier sipas standardeve të përcaktuara dhe sikundër është proceduar edhe në kontratën fillestare.
- 10.12** Kontraktori është i detyruar të lagë me ujë zonën e kantierit të punimeve të ndërimit me qëllim eliminimin e ndotjes së mjedisit si rrjedhim i kryerjes së punimeve.
- 10.13** Kontraktori është i detyruar të pajisë me uniformë pune të gjithë personelin punëtor. Uniformat e punës duhet të kenë të evidentuar emrin e kontraktorit si dhe të jenë të pajisura me shirita fosforike për tu dalluar natën.
- 10.14** Kontraktori është i detyruar të përdori mjeket e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërimit. Këto mjete duhet te vendosen ne menyre të dukshme për të gjithë.
- 10.15** Kontraktori është i detyruar të vendosë në kantier të gjitha makineritë dhe mjeket e e nevojshme nga mjeket e deklaruarra ne kontratën fillestare dhe të nevojshme për përmirshjen dhe realizimin e shtesës së kontratës Mjeket e garkullimit duhet të jenë të pajisura me lejet perkatëse.
- 10.16** Në rast të mos respektimit të dispozitave të parashikuara në pikën 10.8 Mbikqyrësi i punimeve i bën njoftim me shkrim Kontraktorit për respektimin e detyrimeve të shprehura në lart dhe korrigjimin e tyre. Në rast se Kontraktori nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëhere Mbikqyrësi i punimeve i propozon Investitorit, Autoritetit Kontraktor aplikimin e një penalteti në masën nga 50.000 Lekë deri 200.000 lekë, penaltet i cili do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.
- 10.17** Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor sic kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve
- 10.18** Te gjitha te drejtat e prones intelektuale te siguruara nga kontraktori gjate zbatimit te shtesës së kontrates do ti perkasin Autoriteit Kontraktor i cili mund ti perdore ato sipas gjykimit te tij.
- 10.19** Kontraktori, pas përfundimit të shtesës së kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të shtesës së kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me shtesën e kontratës pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

## *Neni 11*

### *Kontrolli i Cilësisë*

- 11.1** Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e shtesës së kontratës.
- 11.2** Sapo shtesa e kontratës të fillojë efektet e saj teknike dhe financiare, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtnesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e shtesës së kontratës.
- 11.3** Mblikqyrësi i punimeve duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.
- 11.4** Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

#### *Neni 12*

##### *Ekzekutimi i Punimeve*

- 12.1** Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e shtesës së kontratës menjëherë me nenshkrimin e saj, kohë në të cilën do të fillojnë dhe efektet teknike -financiare të zbatimit të kësaj shtesë kontrate dhe duhet ti mbarojë Punët brenda afatit të përcaktuar në Nenin 3 te kësaj shtese kontrate.

#### *Neni 13*

##### *Testimet dhe Inspektimet*

- 13.1** Kontraktori është i detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do të përdoren në objekt si dhe provat e kampioneve të marra nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Mblikqyrësi i Punimeve dhe nga normativat në fuqi.
- 13.2** Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e shtesës së kontratës. Kostoja e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda kushteve të çmimit të shtesës së kontratës.
- 13.3** Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të pa parashikuara në shtesë kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se ndërtimet janë konform specifikkimeve dhe kushteve të kësaj shtese kontrate.
- 13.4** Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim ndërtimi që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikkimeve teknike të kontratës mëmë dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e shtesës së kontratës.
- 13.5** As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve te ndërtimit nuk do ta lirojë Kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas shtesës së kontratës.

#### *Neni 14*

## *Garancitë*

- 14.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përijashim kur parashikohet ndryshe në shtesë kontratë.
- 14.2 Me përijashim të ndonjë parashikimi në këtë kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

- 14.3 Materialet e përdorura duhet të përmbushin standardet shtetërore në fuqi.

## *Neni 15*

### *Sigurimi Teknik*

- 15.1 Kontraktori është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë në kantierin e ndërtimit, duke zbatuar masat korrigjuese dhe rregullat e sigurimit teknik për gjithë personelin sikurse përcaktohet në legjislacionin Shqiptar.

## *Neni 16*

### *Rreziqet e Kontraktorit dhe Forca Madhore*

- 16.1 Kontraktori ka për detyrë të përballojë të gjitha shpenzimet që mund të dalin nga data e fillimit të punimeve të kësaj e deri në fund të periudhës së garancisë për difektet që mund të shfaqen në objekt sipas të dhënave të shtesës së kontratës. Kontraktori deri në përfundim të punimeve do të përballojë rreziqet për shkak të dëmtimeve të personelit, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë (përfshirë pa kufizime punimet, materialet dhe paisjet, kantierin e ndërtimit si dhe objektin e ndërtimit).
- 16.2 Kontraktori nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të shtesës së kontratës jo për fajin e tij, dëmeve të likuiduara ose ndërprejten për mosplotësim në se dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas shtesës së kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 16.3 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Investitorit gofë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 16.4 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Investitorin. Me përijashim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas shtesës së kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjettet e arsyeshme për zbatimin e shtesës së kontratës deri në masën e mos pengesës nga Forca Madhore.

## *Neni 17*

### *Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit*

17.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e shtesës së kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

17.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të shtesës së kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dëshon në dorëzimin e punës brenda Afatit të Dorëzimit të Plotë të specifikuar në këtë kontratë.

17.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

17.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

17.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të shtesës së kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

#### *Neni 18*

#### *Sigurimi*

18.1 Kontraktori duhet të sigurojë shtesën e objektit me vlerë totale: **13.375.583 (trembe dhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre)** lekë, me emra të përbashkët të investitorit dhe Kontraktorit, deri në datën e realizimit të plote të ndërtimeve, për humbje ose dëmtim të Ndërtimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

18.2. I gjithë ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmtim e shkakuar. Në se Kontraktori dëshon të sigurojë certifikatat e kërkuara të siguracionit, shtesa e kontratës do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosi të zgjasë periudhën e paraqitjes të certifikatave të siguracionit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrersi koston e tij nga pagesa që i jep Kontraktorit.

18.3 Ndryshime në kushtet dhe afatet e siguracionit nuk duhet të bëhen pa aprovimin me shkrim të Investitorit.

#### *Neni 19*

#### *Preventivi*

19.1 Shtesa e Kontratës përfshin një preventiv për njësi. Preventivi do të përfshijë të gjitha zërat e punimeve shtesë me çmimet përkatëse të parashikuara në ofertë.

19.2 Preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e shtesës së kontratës. Kontraktori paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit të rishikuar me punimet e

paparashikjuara shtesë, bazuar për çdo zë pune të preventivit me cminim në njësi për secilin zë punimesh.

19.3 Për zërat e reja, të paparashikjuara në preventiv përveç dokumentacionit përkatës është paraqitur edhe analiza teknike për çdo zë të ri pune e cila i është paraqitur Mbikqyrësit të Punimeve nga Kontraktori. Mbikqyrësi i Punimeve pasi ka bërë kontrollin e analizës teknike ia ka cuar për miratim Autoritetit Kontraktor i cili ka miratuar punimet shtesë të dala gjatë zbatimit të kontratës fillestare dhe mbi të cilat është zhvilluar procedura eprokurimit për lidhjen e kësaj kontrate shtesë.

19.4 Nën/zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë gminim për njësi në ofertën e paraqitur, do të konsiderohen si të mbuluara nga vlerat e tjera të përfshira në shtesë kontratë.

#### *Neni 20 Korrigjimi i Difekteve*

20.1 Sa herë që gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve, nga Autoriteti Kontraktor konstatohet një difekt Kontraktori është i detyruar ta korrigjojë atë brenda afatit që i lihet me shkrim por jo më vonë se 15 ditë.

20.2 Gjatë periudhës së garancisë së punimeve Autoriteti Kontraktor do të njoftojë Kontraktorin lidhur me çdo difekt para mbarimit të kësaj periudhe. Për eliminimin e difekteve lihet një afat i cili saktësohet sipas çdo rasti konkret por jo më shumë se 15 ditë.

20.3 Periudha e garancisë për difektet është afati 24 muaj. Me përfundimin e kësaj periudhe Kontraktori paraqit kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila i është mbajtur nga Investitori. Ky i fundit, brenda 10 ditëve organizon vizitën në terren ku kontrollohen realizimet e detyrave të lëna nga korrigjimi i difekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Në se janë kryer gjithë korrigjimet e difekteve atëhere hartohet akti përkatës i marrjes në dorëzim të objektit dhe që shënon përfundimin e detyrimeve reciproke të shtesës së kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të mbikqyrjes së punimeve.

20.4 Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje të shtesës së kontratës për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

#### *Neni 21*

#### *Difektet e Pakorrigjuara*

21.1 Në qoftë se Kontraktori nuk korrigjon difektet e konstatuara në periudhën e garancisë së difekteve, brenda afatit të përcaktuar, Autoriteti Kontraktor do të vlerësojë koston e korrigjimit të difektit, dhe Kontraktori do të paguaj këtë shumë, së bashku me një gjobë të veçantë e cila do të jetë 0.04% të vlerës së kontraktuar për çdo ditë vonesë. Autoriteti Kontraktor do ta mbajë këtë shumë duke e zbritur nga garancia e punimeve e cila është mbajtur progresivisht në situacione.

21.2 Në se me përfundimin e periudhës së garancisë Kontraktori nuk ka korrigjuar difektet e konstatuara Autoriteti Kontraktori zbrit nga garancia deri në konfiskimin e krejt garancisë së punimeve.

#### *Neni 22 Situacionet*

- 22.1 Kontraktori do t'i paragesë Mbikqyrësit të Punimeve brenda 5 ditëve të para të muajit situacionin mujor progresiv për punimet e kryera shesë, duke zbritur pagesat e situacioneve të mëparëshme, garancinë e difekteve, paradhënien efi., të kësaj natyre, sikurse përcaktohet në këtë shtesë kontratë.
- 22.2 Mbikqyrësi i Punimeve do të kontrollojë punën e kryer nga Kontraktori dhe do të vërtetojë shumën që duhet ti paguhet Kontraktorit brenda 10 ditëve nga paraqitja e situacionit. Gjatë kontrollit Mbikqyrësi përcakton vlerën e punimeve shtesë të kryera.
- 22.3 Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe të shprehura në preventiv, vlerën e ndryshimeve dhe të rasteve të kompensuara pa prekur fondin rezervë i cili do financohet në situacionin përfundimtar në se ka dokumenta që argumentojnë përdorimin e tij.

*Neni 23*  
*Kushtet e pagesës*

- 23.1 Pagesat për çdo situacion punimesh do të kryhen nga Autoriteti Kontraktor brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së situacionit nga Mbikqyrësi i Punimeve tek Autoriteti Kontraktor. Pagesat e situacioneve do të kryhen në numrin e llogarisë bankare te Kontraktorit (Banka Societe Generale Albania) me Nr: 00001254023.
- 23.2 Financimi i objekti me fonde të miratuar me anë , venë në dispozicion me anë të VKB nr.52, datë 06.07.2016 për ” Për miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhettit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2016” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr:103/1 Prot të datës 21.01.2016,
- 23.3 Pagesa e situacioneve do të kryhet sipas financimit të parashikuar në pikën 2 të kësaj shtese kontrate.
- 23.4 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

*Neni 24*  
*Rastet e Kompensuara*

- 24.1 Rastet e kompensuara për të cilat vonesa justifikohet do të konsiderohen si vijojnë:
- a) Mbikqyrësi i Punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet) specififikimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve shtesë në kohën e caktuar.
  - b) Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon Kontraktorin për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat pas kryerjes së punimeve shtesë .
  - c) Autoritet Publike ose Autoriteti Kontraktor shkaktojnë vonesa në lirin e sheshit të ndërimit për Kontraktorin.
  - d) Autoriteti Kontraktor vonon pa arsye lëshimin e certifikatës së marrjes në dorëzim.
- 24.2 Kompensimi i rasteve të sipërpërmendura do të bëhet si vijon:

Për vonesat e përmendura në pikat 24.1 (a,b,c,d) Autoriteti Kontraktor do të njohë shtyrjen e datës së përfundimit të punimeve mbi atë të parashikuar në këtë shtesë kontratë.

*Neni 25*  
*Dënshpërblimi për Vonesat*

- 25.1 Kontraktori do ti paguaj Investitorit dëmshtëpërblimin për vonesa në afatin e përfundimit të punimeve në masën 4/1000 në ditë të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i shtesës së kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së shtesës së kontratës.
- 25.2 Sasia e përgjithshme e dëmeve të llogajduara nuk do të tejkalojë 25% të vlerës së shtesës së Kontratës. Autoriteti Kontraktor do të zbrësë dëmshtëpërblimin për vonesat nga pagesa e fundit e Kontraktor.

*Neni 26*

*Garancia e Difekteve*

- 26.1 Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës së shtesës së kontratës që do ti mbahet nga çdo situacion Kontraktorit si garanci për cilësinë e punimeve shtesë, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, duke marrë parasysh edhe sanksionet e parashikuara në këtë shtesë kontrate.

*Neni 27*

*Kostoja e Riparimeve*

- 27.1 Dëmtimi i punimeve shtesë ose humbja e materialeve që do të përdoren për punimet shtesë nga dita e fillimit deri në marrjen në dorëzim si dhe gjatë afatit të garancisë së difekteve do të mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij nëqoftëse humbja ose dëmtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.
- 27.2 Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës, nëse janë për shkak të mosplotësimit të shtesës së kontratës ose të punës jo cilësore të Kontraktor do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

*Neni 28*

*Marrja në Dorëzim e Punimeve*

- 28.1 Kontraktori pas përfundimit të Punimeve shtesë njofton me shkrim Mbikqyrësin e Punimeve dhe Investitorin. Në se Mbikqyrësi nuk ka vërejtje ky njoftim shënon datën e përfundimit të punimeve shtesë. Kontraktori pas njoftimit të përfundimit të punimeve i paraqet brënda 30 ditëve Mbikqyrësit të Punimeve dokumentacionin dhe llogaritet përfundimtare për punimet e kryera. Mbikqyrësi i Punimeve mbas verifikimeve brenda 30 ditëve së bashku me relacionin e tij i'a paraqet gjithë dokumentacionin Investitorit.
- 28.2 Kontraktori duhet t'i kërkojë Mbikqyrësit të punimeve t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe mbikqyrësi i punimeve do t'a bëjë këtë sapa të vendosi se Punimet shtesë janë mbaruar plotësisht.
- 28.3 Nëse mbikqyrësi i punimeve zbulon se Punimet shtesë nuk janë përfunduar plotësisht, mbikqyrësi i punimeve do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerrat e punimeve shtesë ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.
- 28.4 Nëse mbikqyrësi i punimeve zbulon defekte në Punimet shtese, mbikqyrësi i punimeve duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

- 28.5 Mbas marrjes së gjithë dokumentacionit Autoriteti Kontraktor i paraget komisionit të kolaudimit gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit shtesë. Me përfundimin e procedurave të kolaudimit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve shtesë të kryera dhe do të çlirojë garancinë e sigurimit të shtesës së Kontratës. Nga data e akt-kolaudimit të punimeve shtesë fillon periudha e garancisë së punimeve shtesë.
- 28.6 Në fund të periudhës së garancisë së punimeve, Mbikqyrësi i Punimeve dhe komisioni i marrjes në dorëzim të objektit do të përpilojnë së bashku me Autoritetin Kontraktor aktin e marrjes në dorëzim të veprës, objekt i kësaj shtese kontrate.

#### *Neni 30*

#### *Zgjidhja e shtesës së Kontratës*

- 30.1 Autoriteti Kontraktor ose Kontraktori mund të pezullojë kontratën shtesë kur vëren shkelje themelore të saj.

- 30.2 Shkeljet themelore të kontratës shtesë përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon:

- a) Kontraktori nuk fillon punë brenda 5 ditëve nga fillimi i zbatimit të kontratës shtesë si dhe në rastet kur ndalohen punimet me shumë së 10 ditë kur nuk parashikohet në programin e punës dhe ndalimi i punimeve shtesë nuk është i autorizuar nga Mbikqyrësi i Punimeve dhe nuk respektohet grafiku i punimeve.
- b) Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon pezullimin e punimeve shtesë duke njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Kontraktorin.
- c) Kontraktori falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërimit ose bashkimit të shoqërisë.
- d) Kontraktori vonon kryerjen e punimeve shtesë dhe nuk realizon korrigjimet e difekteve të propozuara nga Mbikqyrësi i Punimeve.
- e) Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën shtesë për shkak të Interesit Publik, në cdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për ti shërbyer më mirë interesit publik.

#### *Neni 31*

#### *Pagesa pas Zgjidhjes së shtesës së Kontratës*

- 31.1 Në rast se kontrata shtesë prishet nga Autoriteti Kontraktor për arsye objektive, Mbikqyrësi i Punimeve do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së kryer duke zbritur pagesat e marra deri në ditën e lëshimit të certifikatës.

#### *Neni 32*

#### *Zgjidhja e Mosmarrveshjeve*

- 32.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrveshje që do t'u lindë gjatë realizimit të kësaj shtese kontratë.
- 32.2 Në rast se palët nuk bien dakort atëherë për sqarimin e mosmarrveshjeve ngrihet një grup i përbërë nga tre ekspertë ku secila palë ka paraqitur një ekspert kurse i treti pranohet nga të dy palët. Në rast se problemi nuk zgjidhet nga grupi i ekspertëve atëherë palët do t'i drejtohen Gjykatës Administrative Tiranë.



### *Neni 33*

#### *Legjislacioni Bazë*

33.1 Ligji i aplikueshëm do të jetë Legjislacioni Shqiptar

### *Neni 34*

#### *Sigurimi i Kontratës*

34.1 Pas kryerjes së negocimit dhe përpara lidhjes së kontratës shtesë , kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontratës shtesë në shumën dhe formën e duhur dhe konkretisht ne shumën: **1.605.070 (njëmilion e gjashtëqind e pesëmijë e shtatëdhjetë)** lekë e pranueshme siç specifikohet në kontratën shtesë. Deshtimi për të dhene sigurimin e kontratës shtesë në formën dhe në shumën e kërkuar përpara lidhjes së kontratës do të rezultojë në anulimin e kontratës shtesë .

34.2 Shuma e sigurimit te kontratës shtesë duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas shtesës së kontratës.

34.3 Sigurimi i kontratës shtesë do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve shtesë. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbyshjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

### *Neni 35*

#### *Komunikimi*

35.1Cdo komunikim midis palëve duhet të bëhet më shkrim.

35.2Cdo njoftim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

35.3Cdo miratim i dhënë duhet të behet me shkrim.

35.4Komunikimi midis palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim në adresat e deklaruara nga palët, në rast se ka ndryshim të adresës palët janë të detyruara të informojnë për çdo ndryshim. Njoftimi bëhet efektiv vetëm pasi të dorëzohet.

### *Neni 36*

#### *Përfatësimi i Palëve*

36.1Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfatësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës shtesë.

36.2 Secila palë duhet të lajmërojnë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojnë, duhet të marrin përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të njafueshëm.

36.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrijen e autoritetit të përfaqësuesit.

*Neni 37*

*Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve*

37.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të shtesës së kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose gëminin e kontratës, kushtet ose gëmini i kontratës shtesë do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës shtesë.

*Neni 38*

*Dispozita të Fundit*

38.1 Kjo kontratë do të qubet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga të dy palët. Te gjitha referencat e ditëve do të jene kalendarike. Kjo kontratë u hartua në 5 (pesë) kopje, katër nga të cilat i mban Autoriteti Kontraktor dhe një kopje e mban Kontraktori.

KONTRAKTORI

“ED KONSTRUKSION SHPK & “4A-M” SHPK

PËRFAQËSUESIT/LIGJOR

ALFRED IBRAHIMI

ARDIT METALLAJ

AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA E TIRANËS

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

ERION VELINAJ

